

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA****AC-I-22-0469*****Në ankesën e******Paditësi/Ankuesi*****Q Th**, fshati K, K. Han i Elezit.***Kundër******E paditura*****N.SH PMN "Sharr" (në likuidim)**, të cilën e përfaqëson, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-4559 të datës 26 korrik 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 23 prill 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV-14-4559 i datës 26 korrik 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

### **Rrethanat procedurale dhe faktike:**

Me 12 qershor 2014, paditësi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. GJI042-2469 të datës 14 maj 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (tutje AL) me të cilin atij i ishte refuzuara kërkesa për kompensim për shkak të ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 930.20 euro nga NSH PMN "SHARR" (në likuidim). Paditësi pohoi se, forma e privatizimit të NSH-se nga AKP ishte ilegale dhe se pas privatizimit në vitin 2010 AKP, pa asnjë bazë ligjore dhe në mënyrë të dhunshme i largoi nga puna mbi 200 punëtor. Ka shtuar se punëtorët nuk mund të i plotësojnë të gjitha dokumentacionet që i kërkon AKP, meqë siç dihet dosjet dhe libri amze janë grabitur. Paditësi ka propozuar që të miratohet ankesa sepse është diskriminuese dhe manipuluese se asnjë punëtor nuk e ka kërkuar vullnetarisht ndërprerjen e parakohshme të vendit të punës, siç përshkruhet nga AKP-ja dhe AL, ashtu që i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj ankesën si të bazuar. Ankesës i ka bashkangjitur vendimin e kundërshtuara të AL.

Me 20 qershor 2017, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. AKP-ja thekson se i përmbahet qëndrimit se Autoriteti i Likuidimit ka kryer në vlerësim të saktë të rrethanave faktike si dhe ka zbatuara në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore. Ka pohuar se paditësi nuk ka treguara se cili nen i Ligjit 04/L-034 për AKP-në është shkelur nga AL me rastin e marrjes së vendimit. Ka shtuar se paditësi nuk ka ofruara asnjë agrumet ligjor në mbështetje të ankesës së tij siç parasheh nenin 27.2.4 i Shtojcës së Ligjit për AKP-ne 04/L-033. Ka theksuar se paditësi nuk ka punuar dhe emri i tij nuk rezulton në listën e pendorëve aktiv të NSH-së jo vetëm para privatizimit të NSH-së por edhe shumë koha para privatizimit. Nga librezat e punës mund të shihet se paditësi nuk ka punuar me për NSH-në që nga data 18 gusht 2010, ashtu që si rrjedhojë paditësi nuk ka të drejtë të përfitojë dëmshpërblim nga ndërprerja e parakohshme e marrëdhënies së punës. Rrjedhimisht paditësi nuk e përmbush kushtin e dytë të për përcaktuar me nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në dhe nuk ka të drejtë në dëmshpërblim. I

ka propozuar Gjykatës që ta refuzoj ankesën e paditësit dhe ta vërtetoj vendimin e AL. E paditura i ka bashkangjitur mbrojtjes emërimin e Autoritetit të likuidimit, listën e punëtoreve për transferim, listë pagesa dhjetor 2010, kopjen e librezës së punës për paditësin, parashtresën e dt. 15 nëntor 2013 drejtuar paditësit për të ofruara informacione dhe dëshmi në mbështetje të kërkesës së tij.

Me 26 korrik 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-14-4559, e ka refuzuar kërkesën e paditësit si të pabazuar dhe e ka vërtetuar Vendimin e kundërshtuar të AL si të drejtë dhe të bazuar në Ligj. Shkalla e I-rë, e DHPGJS kishte konstatuar se paditësi përveç vendimit të kundërshtuar të AL nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi për të mbështetur pretendimin e tij se i takon e drejta e kërkuar dhe se marrëdhënia e punës në NSH, i ka pushuar si pasojë e ndonjë veprimi të ndërmarrë nga AKP-ja. Shkalla e I-rë kishte konstatuar se sipas nenit 40.1.6.2 të shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP. Andaj në mungesë të dëshmive dhe duke u bazuar në nenet 42 pika 2 të Ligjit për DHPGJS dhe nenit 7 të LPK-së kërkesën e paditësit e ka refuzuar si të pabazuar.

Me 18 gusht 2022, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-14-4559 të datës 26 korrik 2022, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit, të aprovohet ankesa si e bazuar për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 930.20 euro. Paditësi thekson se në NSH ai ka punuar prej vitit 1973 e deri në likuidimin e saj, por megjë nuk kishte shumë punë në NSH një grup i punëtoreve afër 200 veta i kishin dërguar në pushim prej 60 % dhe kjo ka zgjatur afërsisht 1 vit. Ka shtuar se edhe pse nuk kanë shkuara rregullisht në punë për arsye objektive ata përsëri janë lajmëruar në punë sa herë kur ka pasur nevojë dhe ka qenë i gatshëm për punë. Konsideron që edhe ai si punëtorë i takon e drejta sipas Ligjit për AKP-në.

Me 21 dhjetor 2023, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS-ë një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës së paditësit. Në këtë parashtresë AKP-ja pohon se qëndrimin e saj lidhur me argumentet e Ankesës është qartësisht dhe mjaftueshmërisht i sqaruar në Mbrojtjen e parashtruar si dhe në Aktgjykimit C-IV-14-4559 të DHPGJS, pranë shkallës së I-re. Përsëritja e atyre argumenteve të cilat janë parashtruar më parë do të ishin të pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës, për këtë arsye pala kundërshtarë i parashtron Kolegjit të ankesave që t'i referohet Mbrojtjes së Aktgjykimit përkatës.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjorë, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me 22 prill 2011 kishte paraqitur kërkesë kërkesa për kompensim për shkak të ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 930.20 euro nga NSH PMN "SHARR" (në likuidim), por që AL kërkesën e tij e kishte refuzuar pasi që ishte konstatuar se paditësi nuk ishte punonjës aktiv i NSH-së në kohën e privatizimit të NSH-së dhe se nga librezja e punë se paditësit shihej se paditësit i ishte mbyllur librezja e punës me 18 gusht 2010.

Kolegji i Apelit vëren se me 12 prill 2014, paditësi ka parashtruar pranë DHPGJS-së padi kundër Autoritetit të Likuidimit (AL) GJII042-2469 të datës 14 maj 2014

me të cilën ishte refuzuar kërkesa e tij. Padiësi ankesës i kishte bashkangjitur vetëm vendimin e kundërshtuar të AL.

Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-14-4559, e ka refuzuar kërkesën e padiësit si të pabazuar dhe e ka vërtetuar Vendimin e kundërshtuar të AL si të drejtë dhe të bazuar në Ligj. Shkalla e I-rë, e DHPGJS kishte konstatuar se padiësi nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi për të mbështetur pretendimin e tij se i takon e drejta në kompensim për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Shkalla e I-rë kishte konstatuar se sipas nenit 40.1.6.2 të shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP. Andaj në mungesë të dëshmive dhe duke u bazuar në nenet 42 pika 2 të Ligjit për DHPGJS dhe nenit 7 të LPK-së kërkesën e padiësit e kishte refuzuar si të pabazuar.

Kolegji i Apelit i mbështet këto konstatime dhe gjetje faktike të Shkallës së I-rë, se kërkesa e padiësit ishte e pabazuar. Padiësi nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi të vlefshëm në Shkallë të I-rë për të mbështetur pretendimin e tij për kompensimin për ndërprerje të parakohshme të punës, në shumë prej 930.20 euro nga NSH PMN "SHARR" (në Likuidim). Padiësi po ashtu me asnjë provë nuk ka provuar para AL-së dhe as para Gjykatës se ai ishte punëtor aktiv i N.SH-së, në kohën e privatizimit të saj, në mënyrë që t'i takonte kompensimi për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës. Nga Libreza e Punës e dorëzuar si provë nga e paditura, vërehet se padiësit i ishte mbyllur librezja e punës me 18 gusht 2010, pra para privatizimit të NSH-së, ndërsa privatizimi i NSH PMN "Sharr" ishte bërë me 09 dhjetor 2010 dhe se padiësi me asnjë provë nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën.

Shtojca e Ligjit të AKP-së (Nr.04/L-034), Neni 40.1.6.2, parasheh se parashtruesit gëzojnë të drejtën për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, nëse janë pushuar nga puna si pasojë e, ose në lidhje me një veprim të

AKP-së sipas Nenit 6.1 ose 6.2. Shikuar këto dispozitat, paditësi nuk ka ofruar asnjë dëshmi, me të cilën do të vërtetonte se ai është pushuar nga puna si pasojë e, ose në lidhje me një veprim të AKP-së, në mënyrë që t'i takonte dëmshpërblimi për ndërprerje të parakohshme të punës. Për më tepër paditësi nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi për të mbështetur lartësinë e shumës së kërkuar, apo mënyrën e llogaritjes së shumës prej 930.20 euro.

Kolegji i Apelit gjithashtu vlerëson se me të drejtë Shkalla e I-rë e DHPGJS i është referuara neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, i cili parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese). Edhe neni 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, parasheh që palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio qui dicit). Paditësi ka dështuar të praqes prova për të mbështet kërkesën e tij, prandaj Aktgjykimi i ankimuar është i saktë në rezultat dhe arsyetim ligjor.

Kolegji i Apelit i ka shqyrtuara dhe vlerësuar pretendimet ankimore të paditësit, mirëpo nuk ka gjetura se ka shkelje, pasi që aktgjykimi i ankimuar ka arsyetim të qartë dhe është i mbështetur saktë në dispozita ligjore.

Nga këto arsye, ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

**Taksat gjyqësore**

Në bazë të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr.01/2017, të datës 22 mars 2017, paditësi nuk ngarkohet me taksë gjyqësore, meqë vlera e kontestit është nën shumën prej 1000 euro.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 23 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues

\_\_\_\_\_